



**BASHKIA MIRDITË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 1023/Prot.  
2

Urëshen me, 26 . 03 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 28 datë 18. 03. 2024**

**PËR**

**“MIRATIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Z. NIKOLL NDREC PRENGA, QYTETI RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN”, BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.45/2019 “Për mbrotjen civile”, VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ligji nr 97/2023 “Për bugjetin e vitit 2024” “Udhëzimit Nr 9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” në Vendimin nr. 50, datë 15.12.2023, i Këshillit bashkiak Mirditë, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”, projekt-vendimin nga kryetari i bashkisë së bashku me dosjen e plotë të paraqitur dhe nga Komisioni i Konstatimit mbi dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e familjes së Z. Nikoll Ndrec Prenga në qytetin Rrëshen, njësia administrative Rrëshen, ku si pasojë është djegur plotësisht banesa dhe të gjitha orenditë dhe paisjet elektroshtëpiake dhe pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë dokumentacionin dhe preventivin e dëmit të shkaktuar nga djegia e banesës së familjes së Z. Nikoll Ndrec PRENGA, me një dëm total, i vlerësuar nga komisioni i konstatimit, në masën totale; **1 961 003** (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tre) lekë nga ku:
  - a. Preventivi i vlerësimit nga ana materialeve ndërtimore: **1 267 703** (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tre mijë) lekë.

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

- b. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektro-shtëpiake, në masën: **693 300** (gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind) lekë.
2. Bashkia Mirditë nga fondet e veta akordon ndihmë financiare 50% të vlerës së dëmit në masën **980,501.5** (nëntëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e një, pikë pesë) lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**



**KRYETAR**

**Aleksandër PICA KU**

